

Crna Gora - Mali i Zi, Opština Tuzi - Komuna e Tuzit  
DOO "KOMUNALNO" - SHPK "KOMUNALE"

Broj 1901/22

Tuzi-Tuz, 13.10 2022 god.



**DOO KOMUNALNO TUZI**  
**SHPK KOMUNALE TUZ**

# **NDRYSHIMI I DYTË I PROGRAMIT VJETOR**

**MBI KRYERJEN E VEPRIMTARIVE KOMUNALE  
PËR VITIN 2022.**



TETOR, 2022.

## Përmbajtja e Programit:

<b>I</b>	<b>Hyrje</b>
<b>II</b>	<b>Të dhënat themelore mbi kryerësin e veprimtarive komunale</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Organizimi i brëndshem me skema organizative</li> <li>➤ Aktivitetet primare dhe sekondare të Shoqërisë</li> <li>➤ Organet e menaxhimit dhe drejtimit</li> </ul>
<b>III</b>	<b>Kapacitetet për kryerjen e veprimtarive komunale</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Burimet njerëzore</li> <li>➤ Hapësirat afariste dhe objektet e infrastrukturës komunale</li> <li>➤ Pajisjet dhe mjetet lëvizëse</li> </ul>
<b>IV</b>	<b>Qëllimet</b>
<b>V</b>	<b>Bazat për zhvillimin e Programit</b>
<b>VI</b>	<b>Fushëveprimi i planifikuar fizik i aktiviteteve</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Shërbimi i mbledhjes, transportit dhe deponimit të mbeturinave</li> <li>➤ Shërbimi i rregullimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike, rrugëve lokale dhe varrezave</li> <li>➤ Shërbimi i mirëmbajtjes së tregut, hapësirave publike parkimi dhe stacione autobusi</li> <li>➤ Shërbimi i furnizimit publik të me ujë dhe menaxhimi i ujërave të zeza</li> <li>➤ Shërbimi i mirëmbajtjes së ndriçimit publik</li> <li>➤ Veprimtari të tjera komunale</li> </ul>
<b>VII</b>	<b>Treguesit financiarë të planifikuar</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të ardhurat e planifikuar</li> <li>➤ Shpenzimet (derdhjet) e planifikuar</li> <li>➤ Shpenzimet e planifikuar</li> <li>➤ Plani financiarë</li> <li>➤ Burimet financiare</li> </ul>
<b>VIII</b>	<b>Politika e pagave dhe punësimit</b>
<b>IX</b>	<b>Borxhet</b>
<b>X</b>	<b>Plani i prokurimit publik</b>
<b>XI</b>	<b>Politika e çmimeve</b>
<b>XII</b>	<b>Vërejtjet përfundimtare</b>

Vërejtje: Përmbajtja e programit është në përputhje me dispozitat e nenit 26, paragrafi 1 dhe 2 Ligjit të veprimtarive komunale ("Fleta zyrtare e MZ" numri 055/16, 074/16, 002/18 I 066/19) dhe Rregullores mbi përmbajtjen e detajuar të kryerjes së veprimtarive komunale dhe raportit vjetor për zbatimin e programit vjetor të kryerjes së veprimtarive komunale ("Fleta zyrtare e MZ" nr. 54/20 nga 08.06.2020)



## I HYRJE

Miratimi i programit vjetor për kryerjen e veprimtarive komunale përcaktohet nga dispozitat e nenit 26, paragrafi 1 dhe nenit 29, paragrafi 2, pika 7 e Ligjit mbi veprimtaritë komunale ("Fleta zyrtare e MZ" numri 55/2016;074/16 002/18 dhe 066/19).

Veprimtaritë komunale të konsumit individual dhe të përbashkët komunal, si dhe operacionet afariste të Shoqërisë, në vitin 2021 do të bëhen duke zbatuar bazat ligjore të mëposhtme të Malit të Zi dhe rregulloret komunale të vetëqeverisjes lokale:

### Bazat ligjore

- Ligji mbi Shoqërinë afariste («Fleta zyrtare e MZ» numri 065/20)
- Ligji mbi punën («Fleta zyrtare e MZ» nr. 074/19) 074/19, 008/21, 059/21, 068/21)
- Ligji mbi veprimtaritë komunale («Fleta zyrtare e MZ» numri 055/16, 074/16, 002/18, 066/19)
- Ligji mbi menaxhimin e mbeturinave («Fleta zyrtare e MZ» numri 064/11 dhe 039/16)
- Ligji mbi vetëqeverisjen lokale («Fleta zyrtare e MZ » numri 002/18, 034/19, 038/20)
- Ligji mbi mjedisin jetësor («Fleta zyrtare e MZ» numri 052/16, 073/19, 073/19)
- Ligji mbi mbrojtjen e natyrës («Fleta zyrtare e MZ» numri 054/16 dhe 018/19)
- Ligji mbi prokurimin publik («Fleta zyrtare e MZ» numri 074/19)
- Ligji mbi sigurinë dhe shëndetin në punë («Fleta zyrtare e MZ» numri 034/14 dhe 044/18)
- Ligji mbi pagat e të punësuarve në sektorin publik («Fleta zyrtare e MZ» numri 016/16, 083/16,021/17, 042/17 i 012/18, 039/19, 042/19, 034/19)
- Ligji mbi mbrojtjen e konsumatorit («Fleta zyrtare e MZ » numri 002/14, 006/14, 043/15, 070/17, 067/19)
- Ligji mbi mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve («Fleta zyrtare e MZ» numri 14/08, 040/11, 047/15))

### Dispozitat e qeverisjes lokale

#### »Fleta zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale »numri 033/19 nga 14.08.2019.

- Vendimi mbi rendin komunal të Komunës së Tuzit;
- Vendimi mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Komunalno / Komunale" Tuz;
- Vendimi mbi mirëmbajtjen e pastërtisë;
- Vendimi për kafshët shtëpiake;
- Vendimi mbi veprimtaritë funerale, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave
- Vendimi mbi parkingjet publike (Fleta Zyrtare e Malit të Zi - Rregulloret komunale nr. 046/19)
- Vendim mbi ndyshimin dhe plotësimin e Vëndimit mbi themelimin e SH.PK Komunalno / Komnale Tuzi („Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale“ numri 040/21).

### Akte të tjera:

- Statuti SHPK »KOMUNALNO / KOMUNALE« Tuz të cilit i është dhënë pëlqimi i Kuvendit të komunës së Tuzit
- Marrëveshja për delegimin e kryerjes së veprimtarive komunale dhe përdorimin e infrastrukturës komunale dhe mjeteve të tjera në pronësi të Komunës së Tuzit, numri 01-031 / 20-6785, nga 16 korrik 2020.

Bazat për zhvillimin e programit për kryerjen e veprimtarive komunale mund të gjenden në dokumentet e mëposhtme:

- Projektbuxheti i Komunës së Tuzit për vitin 2022;
- Plani i pritshëm për plotësimin e vendeve të punës të sistemuara në Shoqëri pas hartimit të një akti të ri për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe kryerjen e vazhdueshme të veprimtarive komunale të përcaktuara në përputhje me kontratën për delegimin e kryerjes së veprimtarive komunale;
- Marrëveshja e përgjithshme kolektive - marrëveshja kolektive e Degës për strehimin e veprimtarive komunale, vlefshmëria e së cilës është e kufizuar deri në fund të vitit 2020. që do të thotë se partnerët socialë në nivelin shtetëror duhet të sjellin një marrëveshje të re dhe më pas organizatat e degëve – kontrata kolektive të degëve në vitin 2022. Kjo për marrëveshjet ekzistuese individuale kolektive të punëdhënësit paraqet një ngarkesë të rëndësishme në aspektin e pritjeve të rregulloreve të reja në përputhje me Ligjin e ri mbi punën;
- Plani i mbështetjes financiare për funksionimin e Shoqërisë në prokurimin e pajisjeve themelore për kryerjen e veprimtarive komunale, dhe vazhdimin dhe përfundimin e procesit të bilancit mbi ndarjen ndërmjet ndërmarrjeve të shërbimeve nga Podgorica dhe Shoqërisë sonë;
- Zhvillimi i pritshëm i një Plani të ri shtetëror për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe mbeturinave të parrezikshëme të ndertimit për periudhën 2021-2026 dhe miratimi i planeve të reja lokale në komuna, si dhe zbatimi i aktiviteteve të planifikuara për krijimin e qendrave rajonale të menaxhimit të mbeturinave , duke marrë parasysh që këto plane në nivel shtetëror dhe lokal skadojnë në fund të vitit 2022 dhe ne jemi gati t'i analizojmë ato.

Ligji mbi veprimtaritë komunale është rregullorja themelore ligjore për kryerjen e veprimtarive komunale. Për zbatimin e tij, janë përcaktuar dhe miratuar aktet nënligjore në vijim, sipas të cilave në vitin 2021/2021 Shoqëria duhet të harmonizojë aktet e saj të brendshme:

- ⬇ Dispozita mbi elementet e detajuara dhe metodologjinë për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve komunale (« Fleta zyrtare e MZ »nr. 055/20 nga 12.06.2020.);
- ⬇ Rregullorja mbi përmbajtjen e detajuar të programit vjetor të kryerjes së veprimtarive komunale dhe raportin vjetor për zbatimin e programit vjetor të kryerjes së veprimtarive komunale («Fleta zyrtare e MZ »nr. 054/20 nga 08.06.2020.);
- ⬇ Rregullorja mbi cilësinë minimale dhe fushëveprimin e punës për kryerjen e veprimtarive komunale («Fleta zyrtare e MZ » nr. 054/20 nga 08.06.2020.);
- ⬇ Rregullorja mbi kushtet për kryerjen e veprimtarive komunale («Fleta zyrtare e MZ »nr. 054/20 nga 08.06.2020.g.)
- ⬇ Rregullorja mbi kushtet e detajuara dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të ekzekutorëve së veprimtarive komunale dhe vendimet e nxjerra për përmbushjen e kushteve për kryerjen e veprimtarive komunale («Fleta zyrtare e MZ »nr. 077/17 nga 17.11.2017.)

Nga datat e lartpërmendura të miratimit të akteve nënligjore të përmendura, është e qartë se miratimi i tyre u vonua për më shumë se dy vite (dispozitat dhe rregulloret e miratuara në vitin 2020), kështu që shoqëritë afariste komunale, përfshirë edhe tonën, nuk kishin një bazë ligjore për harmonizimin e akteve të veta të brendshme dhe e njëjta pritet në vitin 2022.



Sipas ligjit të lartpërmendur, rregullimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike, rregullimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta publike, menaxhimi i ndriçimit publik, mirëmbajtja e rrugëve komunale, mirëmbajtja e shtratit të rrjedhave ujore me rëndësi lokale, mirëmbajtja e hapësirave për parkim publik, mirëmbajtja e tualeteve publike, kujdesi për kafshët e braktisura dhe të humbura (kafshët shtëpiake) dhe mirëmbajtja e strehëzave për asgjësimin e tyre janë veprimtari komunale të konsumit të përbashkët komunal, kurse menaxhimi i mbeturinave komunale, mirëmbajtja e tregut dhe shërbimet e varrimit janë aktivitete komunale të konsumit individual komunal.

Neni 14 i Ligjit për Veprimtaritë Komunale përcakton që njësitë e vetëqeverisjes lokale, përkatësisht komuna e Tuzit, në përputhje me ligjin të sigurojë:

- ❖ kushtet materiale dhe teknike për kryerjen dhe zhvillimin e veprimtarive komunale
- ❖ kushtet financiare për kryerjen e veprimtarisë së konsumit të përbashkët komunal
- ❖ ndërtimi dhe mirëmbajtja e investimeve të infrastrukturës komunale

Kontrata për delegimin e kryerjes së veprimtarive komunale, SHPK "Komunalno / Komunale" Tuz, caktoi aktivitetet e mëposhtme komunale:

1. Menxhimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike
2. Mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe rrugëve të pa kategorizuara\*
3. Mirëmbajtja e varrezave publike
4. Mirëmbajtja e hapësirave publike për parkim
5. Menaxhimi i mbeturinave komunale dhe mbeturinave inerte
6. Kujdesi për kafshët e braktisura ose të humbura dhe mirëmbajtja e strehëzave për kujdesin e tyre\*
7. Mirëmbajtja e ndriçimit publik

Aktivitetet nën numrin rendorë 5 është aktivitet të konsumit individual komunal dhe aktivitetet nën numrat rendorë 1, 2, 3, 4, 6 dhe 7 janë aktivitete të konsumit të përbashkët komunal.

Deri në demarkacionin përfundimtar me Kryeqytetin dhe krijimin e kushteve për kryerjen e të gjitha aktiviteteve të parashikuara në Statut, kontratë dhe akte të tjera themeluese, D.o.o. "Komunalno / Komunale" Tuz kryen aktivitetet e mëposhtme:

- Rregullimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike;
- Mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe të pa kategorizuara
- Menaxhimi i mbeturinave komunale dhe të mbeturinave inerte (grumbullimi, transportimi dhe deponimi)
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e rrjedhave ujore me rëndësi lokale;
- Mirëmbajtja e varrezave publike

Të vetëdijshëm për faktin se cilësia e kryerjes së veprimtarive komunale nën kompetencën e shoqërisë sonë, si një ushtrues i veprimtarive komunale në komunën e Tuzit, paraqet një kusht të domosdoshëm për jetën e qytetarëve, shoqërive afariste, me theks të veçantë në ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme dhe bizneset e hotelierisë, si bizneset themelore në mjedisin tonë, programi i kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2022 ka për qëllim plotësimin e nevojave të deklaruara të qytetarëve dhe ekonomisë në të gjithë zonën e komunës së Tuzit.

Duke parë dhe analizuar rezultatet e punës nga viti aktual, pra viti i parë i formimit të kësaj Shoqërie, ne kemi identifikuar drejtimet për zgjidhjen e problemeve aktuale dhe detyrat që duhet të realizohen. Këto janë detyra, disa prej të cilave duhet të kryhen në vazhdimësi veçanërisht gjatë kohëzgjatjes së pandemisë Covid-19 dhe në vitin vijues, të tjerat duhet të kryhen mbrenda mundësive sa më shpejt që të jetë e mundur, siç janë plotësimi i burimeve njerëzore dhe teknike, ndërkohë që qëllimi jonë kryesor është që të gjitha aktivitetet komunale të kryhen me cilësi dhe vazhdimisht gjatë gjithë vitit, në mënyrë që të mbrohet interesi publik, përmes kryerjes së këtyre aktiviteteve në komunën e Tuzit.

Si pjesë e aktiviteteve që janë të detyrueshme sipas Ligjit për Veprimtaritë Komunale, në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale, gjatë vitit 2022 është e nevojshme të theksohen përparësit:

- Përgatitja e listës së çmimeve të shërbimeve komunale të Shoqërisë, në përputhje me nenin 54 paragrafi 3 të Ligjit për veprimtari komunale, për atë qëllim është e nevojshme që vetëqeverisja lokale të zhvillojë dhe paraqesë elementet e përcaktuara me ligj, si më poshtë:
  - kostot e mirëmbajtjes së investimeve të infrastrukturës komunale
  - kostot e ripagimit të huasë për ndërtimin e infrastrukturës komunale dhe blerjen e pajisjeve përkatëse.
- Në përputhje me nenin 73 të Ligjit për veprimtaritë komunale, në vitin 2022 është e nevojshme që vetëqeverisja lokale të paraqesë një kërkesë për regjistrimin e pasurisë shtetërore nga neni 16, paragrafi 1 i ligjit, pas identifikimit të pasurive të patundshme dhe infrastrukturës komunale në të gjitha shoqëritë e themeluara nga ajo.

Në seancën e Kuvendit të komunës së Tuzit, u miratua Vendimi për themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të Kufizuar "Komunalno / Komunale" Tuz (Fleta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale, nr. 033/19 të 14 Gushtit 2019). Ky vendim themeloi një shoqëri, si një shoqëri një-anëtarëshe, me qëllim të kryerjes së veprimtarive komunale. Gjithashtu, kryerja e veprimtarive komunale në vitin 2020 i është deleguar Shoqërisë, duke lidhur një marrëveshje të veçantë për delegimin e kryerjes së veprimtarive komunale dhe përdorimin e infrastrukturës komunale dhe fondeve të tjera në pronësi të Komunës së Tuzit.

Duke pasur parasysh se Vendimi për Themelimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Komunalno/Komunale" Tuz është ndryshuar më 24.11.2021, dhe kështu erdhi deri te formimi i dy Shoqërive të reja, përkatësisht SHPK "Ujësiellësi dhe Kanalizimi" dhe SHPK "Tregjet". Gjatë vitit 2022 do të harmonizohen aktet e Shoqërisë, siç është Statuti, rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, si dhe marrëveshja për besimin e veprimtarive komunale dhe shfrytëzimin e infrastrukturës komunale dhe mjeteve tjera në pronësi të Komunës së Tuzit.

Financimi i aktiviteteve që kanë karakter të interesit publik bëhen nga buxheti i komunës, nga fondet e realizuara duke ofruar shërbime në kuadër të aktiviteteve të Shoqërisë, donacioneve dhe burimeve të tjera në përputhje me ligjin.

**Punët e financuara nga buxheti i komunës së Tuzit si shpenzime të përbashkët komunal janë:**

- Rregullimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike,
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e shtratit të ujrrjellave me rëndësi lokale
- Mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe varrezave



- Mirëmbajtja e hapësirës së parkimit
- Mirëmbajtja dhe rregullimi i stacionit të autobusit
- Kujdesi për kafshët e braktisura ose të humbura dhe mirëmbajtja e strehëzave për kujdesin e tyre.
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e deponimeve të përkohshme dhe zonave të riciklimit
- Sanimi i deponive të egra
- Mirëmbajtja e rrietit të ndriçimit

**Punët që financohen nga fondet vetanake janë:**

- Menaxhimi, grumbullimi, transportimi dhe deponimi i mbetjeve komunale,
- Mbledhja e mbeturinave inerte dhe deponimi,
- Mbledhja e mbetjeve të gjelbërta dhe deponimi,

**Shoqëria gjithashtu kryen veprimtari që nuk kanë karakterin e aktiviteteve me interes publik, si më poshtë:**

- ngarkimin, transportimin dhe deponimi i mbeturinave të parrezikshëme me kërkesë të palëve të treta
- transporti i ujit teknik dhe larja e sipërfaqeve me kërkesë të palëve të treta

Fondet për kryerjen e veprimtarive që nuk kanë karakter të interesit publik sigurohen nga të ardhurat e veta të Shoqërisë.

Nga të gjitha veprimtaritë komunale, përveç rritjes së sasisë dhe strukturës së mbeturinave të hedhura të të gjitha llojeve, SHPK. "Komunalno / Komunale" Tuz më së shumti ballafaqohet me problemin e hedhjes të pa planifikuar të mbeturinave inerte dhe krijimin e deponive të egra, dhe kështu vështirësohen kushtet e punës për shkak të mungesës së ndërgjegjes së qytetarëve dhe mungesës së pajisjeve teknike të Shoqërisë. Gjithashtu, ngarkesa e infrastrukturës së trafikut në Tuz, si një qytet tranzit në kufi me Shqipërinë, me rritjen e numrit të automjeteve, çon në mbingarkesë dhe numër të pamjaftueshëm të hapësirave për parkim.

Ky Program përfshin veprime dhe aktivitete që synojnë ta bëjnë zonën e komunës së Tuzit, kryesisht vendet publike, më të pastra dhe të rregullta, për të mirëmbajtur rrugët lokale, për t'u siguruar qytetarëve ujë të pijshëm cilësor, për të punuar në mirëmbajtjen dhe ekonomizimin e sistemeve të ndriçimit publik dhe kështu të identifikojë drejtimit për zgjidhjen e problemeve dhe detyrave aktuale që duhet realizuar.

Problemi i demarkacionit me Kryeqytetin mbetet akoma, i cili çon në shtyrjen dhe marrjen e veprimtarive komunale dhe mekanizimin që supozohej të na jepej gjatë ndarjes së kompetencave, në të cilën Shoqëria do të përqendrohet më shumë në vitin 2022.

Analiza e vlerësimeve të rezultateve u bë në bazë të analizës së prerjes të gjendjes së treguesve financiarë, analizës së gjendjes aktuale të suksesit të bilancit, si dhe në bazë të parashikimit të shpënzimeve dhe detyrimeve për vitin e ardhshëm.

## II Të dhënat kryesore për kryerësin e shërbimeve komunale


TABELA (të parapara me nenin 4, shtesë Rregullore)

Nr.	TË DHËNAT KRYESORE PËR KRYERËSIN E SHËRBIMEVE KOMUNALE	
1.	<b>Të dhënat kryesore të identifikimit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ emërtimi</li> <li>▪ selia</li> <li>▪ të dhënat mbi themeluesin</li> <li>▪ numri amëz</li> <li>▪ NIPT</li> <li>▪ TVSH</li> </ul>	SH.P.K. „KOMUNALNO/KOMUNALE“ TUZ Rruga nr. pn, 81206 TUZ, Rruga12, nr.2 Kuvendi I Komunës Tuz  03283135 33/31-00037-295
2.	<b>Forma e organizimit</b>	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
3.	<b>Aktet themeluese</b>	Vëndimi KK TUZ. („Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale“ numri 033/19). Vendim mbi ndyshimin dhe plotësimin e Vëndimit mbi themelimin e SH.PK Komunalno / Komnale Tuzi („Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale“ numri 040/21).
4.	<b>Çështjet e statusit juridik</b>	Shoqëri e pavarur një-antarshe themelues i së cilës është Kuvendi i Komunës së Tuzit. Shoqëria afariste operon me asete në pronësi të shtetit.
5.	<b>Struktura e pronësisë</b>	Komuna e Tuzit 100%
6.	<b>Organizimi i brendshëm (shema organizative – shtesa me tabelë)</b>	Akti mbi organizimin e brendshëm e sistematizimit numri
7.	<b>Aktivitet kryesore</b>	Aktiviteti kryesor: 39.00 Pastrimi i mjedisit dhe aktivitete tjera që kanë të bëjnë me mbeturina
8.	<b>Organi i menaxhimit dhe drejtimit</b>	Bordi i Drejtoreve: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nikola Siništaj, Kryetar</li> <li>• Anton Lulgjuraj, anëtar</li> <li>• Elma Drešaj, anëtare</li> </ul> Drejtori Ekzekutiv: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nikolla Camaj</li> </ul>
9.	<b>Të dhëna tjera specifike për kryerësin e shërbimeve</b>	Kontakt + 382 (0)67 073295 Web sajt: <a href="http://www.komunalno-tz.me">www.komunalno-tz.me</a> e-mail: <a href="mailto:info@komunalno-tz.me">info@komunalno-tz.me</a> Vendimi për regjistrim në CRPS, 5-0905198/001 i datës 08.10. 2019.

shtojcë



Skema e organizimit të brëndshem



### **Sektori i shërbimeve të përgjithshme dhe të përbashkëta përbëhet nga:**

- Shërbimi i punëve të përgjithshme dhe juridike
- Shërbimi për punë financiare dhe komerciale
- Shërbimi i suportit teknik dhe servisi

### **Sektori për shërbime komunale përbëhet nga:**

- Shërbimi i grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave
- Shërbimi për rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, rrugëve lokale dhe varrezave
- Shërbimi i mirëmbajtjes së hapësirave të parkimit publik dhe stacionit të autobusave
- Shërbimi i menaxhimit të ndriçimit publik

Në përputhje me nenin 9 të Statutit të Shoqërisë, Shoqërisë i është deleguar veprimtaria e aktiviteteve komunale si vijon:

- mbledhja mbeturinave të parrezikshëme, si aktivitete dominante, në Ligjin për Klasifikimin e aktiviteteve të përcaktuara në sektorin E, zona 38, dega 38.1, grupi 38.11
- mirëmbajtja dhe pastrimi i hapësirave publike
- mbledhja, transporti dhe deponimi i mbetjeve komunale për nevoja të shfrytëzuesve të shërbimeve dhe
- mbledhja dhe tregtimi me lëndë sekondare.

Shoqëria kryen veprimtari komunale, të parashikuara me Ligj për klasifikimin e aktiviteteve ("Fleta Zyrtare e MZ", numri 18/11) si veprimtari dominuese si vijon:

38.11, 38,21, 38,32 –ripërdorimi i materialeve mbetëse,

39 –Pastrimi i mjedisit dhe aktivitete të tjera në lidhje me menaxhimin e mbeturinave,

81.3 –Shërbimi i mirëmbajtjes

Veprimtarit nga paragrafi I i këtij neni janë aktivitete me interes publik.

## **III Kapacitetet e kryerësve të veprimtarive komunale**

### **Burimet Njerëzore**

Kur flasim për kapacitetet e burimeve njerëzore në dispozicion të Shoqërisë, pjesërisht mbulohen vendet e punës të parapara me rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Nevojat në vitin 2022 tregojnë qartë nevojën e punësimit të fuqisë punëtore të munguar, veçanërisht në pjesën operative të Shoqërisë. Parakushti bazë për një zgjidhje cilësore të kësaj çështjeje është rregullimi i problemeve me kryeqytetin, marrja e punonjësve dhe mbushja e sektorëve dhe shërbimeve. Për një strukturë të detajuar të punonjësve dhe politikës së punësimit, shihni Kapitullin VIII të Politikës së Pagave dhe Punësimit.



## Hapësira për punë dhe objektet e infrastrukturës komunale

Selia e Shoqërisë gjindet në Tuz, rruga 12, numri 2 e cila është marrë me qira, dhe e cila do të jetë edhe në vazhdim e tillë deri në një njoftim tjetër, gjithashtu zotëron një magazinë të vogël në pronësi të themeluesit për pajisje dhe rekuizita.

### Pajisjet dhe Mjetet lëvizëse

Shoqëria, si pajisje posedon një sharrë elektrike me zinxhir të markës Stihl, 1 sharrë për prerje të gjelbërimit, 10 makinë prerëse, 2 kositës dore dhe 2 ventilator për gjethe. Sa i përket mjeteve lëvizëse Shoqëria aktualisht posedon një makinë mbeturinash Mercedes, e cila është huazuar nga ndërmarrja komunale Budva, si dhe një grajfer të tipit Mercedes i cili poashtu është i huazuar.

## IV Objektivat

Ligji për shoqëritë afariste përcakton që secila Shoqëri është themeluar dhe operon në mënyrë që të sigurojnë kryerjen e veprimtarive të përhershme për interes të përgjithshëm si dhe përmirësimin e kryerjes së aktiviteteve me interes të përgjithshëm, duke siguruar sistemin tekniko-teknologjik dhe ekonomik dhe harmonizimin e zhvillimit të tij, arritjen e përfitimit dhe interesave tjera të parapara me ligj.

### Objektivat Themelore

1. **Përfundimi i procedurës së formimit të shoqërisë dhe plotësimi i saj me burime njerëzore, pajisje dhe makineri të nevojshme.**
2. Rregullimi i vendndodhjes për akomodim dhe vënjes në funksion të pjesës tekniko-operative të Shoqërisë në kapacitet të plotë.
3. Formimi i sektorëve dhe shërbimeve sipas aktit për organizimin e brendshëm dhe sistemazimit të vendeve të punës, me fokus në pjesën operative të Shoqërisë.
4. Vendosija e një sistemi cilësor, funksional dhe të qëndrueshëm të veprimtarive komunale në të gjithë zonën e komunës së Tuzit.
5. Përgatitja e akteve të nevojshme interne, në bazë të ligjit të punës, ligjit për kontabilitet, ligjit për veprimtari komunale, ligjit për ujra, ligjit për mbeturina dhe ligjit për mbrojtjen shëndetsore në punë si ligje kryesore sistematike.
6. Mirëmbajtja dhe puna e pandërprerë në komunikim me themeluesin, me shfrytëzuesit e shërbimeve, me organet shtetërore, me transparencë të plotë të Shoqërisë.

Udheheqësia e Shoqërisë u bëri ftesë të gjithë të punësuarve (punësuarit), në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara, të japin kontributin e tyre të plotë në realizimin objektivave të miratuara.

Në këtë mënyrë ne duam të përmirësojmë vazhdimisht:

- Kënaqësia e shfrytëzuesve të shërbimeve tona dhe palëve të tjera që kanë interesim
- **Shkalla e arritjes së qëllimeve të Shoqërisë, veçanërisht ato që lidhen me nivelin e proceseve, shërbimeve dhe organizimit në tërësi**
- Niveli i cilësisë së shërbimeve dhe efektet e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe të punës
- Partneriteti, besimi i vetëqeverisjes lokale dhe shoqërisë në tërësi dhe rritja e numrit të shfrytëzuesve të shërbimeve tona

- Rezultati financiar për të investuar në njohuri, teknologji dhe pajisje të reja
- Kënaqësia e punonjësve dhe kontributi i tyre në realizimin e këtyre qëllimeve

## V Bazat për krijimin e programit

Kryerja e veprimtarive komunale si dhe veprimtaria e vet Shoqërisë në vitin 2021 do të kryhen duke zbatuar rregulloret kryesore të vëndimit mbi vetëqeverisjen lokale:

### **Rregulloret themelore ligjore:**

- Ligji mbi Shoqëritë («Fleta Zyrtare e MZ» numri 065/20)
- Ligji mbi punën («Fleta Zyrtare e MZ» numri.074/19, 008/21, 059/21, 068/21)
- Ligji mbi veprimtari komunale («Fleta Zyrtare e MZ» numri 055/16,074/16,002/18,066/19)
- Ligji mbi Menaxhimin e mbeturinave («Fleta Zyrtare e MZ» numri 064/11 i 039/16)
- Ligji mbi vetëqeverisje lokale («Fleta Zyrtare e MZ » numri 002/18, 034/19, 038/20)
- Ligji për mjedisin jetësor («Fleta Zyrtare e MZ» numri 052/16 dhe 073/19)
- Ligji mbi mbrojtjen e natyrës («Fleta Zyrtare e MZ» numri 054/16 dhe 018/19)
- Ligji mbi prokurimet publike («Fleta Zyrtare e MZ» numri 074/19)
- Ligji mbi mbrojtjen dhe shëndetin në punë («Fleta Zyrtare e MZ» numri 034/14 i 044/18)
- Ligji për pagat e punonjësve në sektorin publik («Fleta Zyrtare e MZ» numri 016/16, 083/16,021/17, 042/17 i 012/18, 039/19, 042/19, 034/19)
- Ligji për mbrojtjen e konsumatorit («Fleta Zyrtare e MZ » numri 002/14, 006/14, 043/15 i 070/17, 067/19)
- Ligji për mbrojtjen e kafshëve («Fleta Zyrtare e MZ» numri 14/08, 040/11, 047/15)

### **Aktet dhe rregulloret themelore komunale**

- Vendimi mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Komunalno/Komunale“ Tuz („Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale „, nr. 033/19 nga data 14.08.2019.)
- Vendim mbi ndyshimin dhe plotësimin e Vëndimit mbi themelimin e SH.PK Komunalno / Komnale Tuzi („Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale“ numri 040/21).
- Statuti i sh.p.k. “Komunalno/Komunale” Tuz dhe vendimi për dhënien e pëlqimit për Stautin sh.p.k. "Komunalno/Komunale" Tuz ("Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale", nr. 039/19 nga data 24.09.2019)
- Kontrata për besimin e kryerjes së veprimtarive komunale dhe shfrytëzimi i infrastrukturës komunale dhe mjeteve tjera në pronësi të Komunës së Tuzit, nr. 01-031/20-6785 nga data 16.07.2020.
- Vendimi për rendin komunal (“Fleta Zyrtare e MZ –diapozitat komunale”, nr. 033/19 nga data 14.08.2019.)
- Vendimi për ruajtjen e pastërtisë ("Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale", nr. 033/19 nga data 14.08.2019)
- Vendimi për kafshët shtëpiake (“Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale” nr. 033/19 nga data 14.08.2019.)
- Vendimi për rrugët komunale dhe të pa kategorizuara në territorin e komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale” nr. 033/19 nga data 14.08.2019.)
- Vendimi për parkingjet publike në territorin e Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale” nr. 046/19 nga data 19.11.2019)



- Vendimi për transportin e rregullt dhe periferik të udhëtarëve në territorin e Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale” nr. 033/19 nga data 14.08.2019.)
- Vendimi për veprimtari funerale dhe mirëmbajtje të varrezave (“Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale” nr. 033/19 nga data 14.08.2019.)

## VI Planifikimi i aktivitetit fizik

Duke u nisur nga fakti që Shoqëria është në hapat e parë të biznesit, dhe duke marrë parasysh situatën faktike të mungesës së pajisjeve dhe makinerive të nevojshme për funksionim të qetë, si e tillë, Shoqëria përpiqet të sigurojë pajisjet e nevojshme dhe të zgjerojë aktivitetet e saj. Përkundër situatës faktike, Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj dhe do të përpiqet të arrijë aktivitetet e mëposhtme:

- Ruajtja e intensitetit të bashkëpunimit ndërmjet punonjësve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve gjë që krijon parakushtet për përmirësimin e punës në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe ruajtjen e një ambienti të shëndetshëm,
- Shfrytëzimi maksimal i të gjitha potencialeve të Shoqërisë (njerëzore dhe materiale - teknike), për të ruajtur stabilitetin financiar të Shoqërisë, duke gjetur mënyra inovative për të ofruar shërbime jo standarde për qytetarët dhe personat juridikë,
- Pagesat të paktën në nivel nga 80 %, për të mos rrezikuar afarizimin e Shoqërisë.
- Vazhdoi me praktikën e mirë të përmirësimit të kapaciteteve profesionale të punonjësve përmes trajnimit, edukimit dhe trajnimit, në përputhje me mundësitë,
- Ruajtja e nivelit të cilësisë së procesit të punës për të gjitha aktivitetet e tjera në drejtim të racionalizimit maksimal të punës dhe kostove operative.
- Rritja e të ardhurave duke kryer shërbime të rregullta dhe të jashtëzakonshme për klientët sepse të ardhurat më të larta mundësojnë pavarësinë financiare të Shoqërisë, duke ruajtur likuiditetin për të mbuluar të gjitha kostot dhe aftësinë për të grumbulluar fonde për të investuar në pajisje që zhvlerësohen në 80% të rasteve. Në atë mënyrë, të ardhurat më të larta do të eliminonin humbjen në biznes, do të rregullonin afatet për pagimin e të ardhurave personale, pagesën e të ardhurave publike (tatimi mbi vlerën e shtuar, kontributet mbi bazën më të ulët) që kërkon ligji.
- Të organizohen aksione me shkolla, ku do të mbillen bimët gjatë rrugës për në Hot, Vllanë dhe Milesh. Në këtë mënyrë, ne do të rrisim ndërgjegjësimin e popullatës sonë më të re në lidhje me mirëmbajtjen dhe pastërtinë dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Në periudhën e ardhshme, të prokurojë 100 kontejnerë dhe t'i shpërndajë ato në vendet e nevojshme, si dhe të rehabilitojë ato të shkatërruara
- Të shpërndahen kontejnerë betoni në qendër të qytetit sipas skicës që do të bëhet më vonë për vitin 2022
- Instalimi i kontejnerëve gjysmë nëntokësorë prej 3m<sup>3</sup> ku do të lehtësonte më tej mirëmbajtjen e pastërtisë në qytet
- Të ndërtohet një azil për kujdesin e kafshëve shtëpiake të braktisura në periudhën e ardhshme
- Të ndërtohet një oborr reciklimi në periudhën e ardhshme, ku Shoqëria, me projekte IPA dhe projekte të tjera të BE-së dhe me ndihmën e komunës së Tuzit, ka siguruar makinën e nevojshme për funksionim të kantierit për reciklim
- Sigurimi i minimum dy automjeteve zyrtare që do tu shërbenin punonjësve të shërbimeve për të transferuar pajisjet e tyre në destinacionin e punës, si dhe për shpërndarjen e faturave për personat juridikë dhe fizik.

- Në periudhën e ardhshme do të sigurohen 10 kontejnerë  $V = 5m^3$ , si dhe një makinë e specjализuar për zbrazjen e këtyre kontejnerëve, e cila do të lehtësonte depozitimën e deponive të egra për qytetarët.
- Në periudhën e ardhshme të prokurohet një grirëse për degë, e cila do ta lehtësonte shumë punën e Shoqërisë, kur bëhet fjalë për deponi të egra.

### Shërbimi i grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave

Mirëmbajtja e pastërtisë në kuptim të këtij vendimi është:

- Grumbullimi, transporti dhe depozitimi i mbetjeve mbeturinave komunale dhe mbeturinave të tjera artificiale (ndertimore dhe mbetjet nga automjetet, etj.) nga vendet publike dhe private.
- Pastrimi dhe larja e hapësirave publike,
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e parqeve, zonave publike të gjelbërta dhe rekreacionit: mbjellja e pemëve, barit dhe bimëve tjetër, kositja e barit dhe prerja e pemëve, mirëmbajtja, pajisja dhe restaurimi i materialit bimor,
- Grumbullimi i kufomave të kafshëve të ngordhura nga vendet publike dhe largimi i tyre, si dhe largimi i automjeteve të dëmtuara dhe të braktisura nga vendet publike. Zonat publike përfshijnë: rrugët, shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta, sheshe, mbikalime dhe nënkalime, shkallë që lidhin zonat e transportit publik, stacione takimesh dhe ndalesa, parkingje, shetitore, sheshe, lëndina, gjelbërim përgjatë rrugëve, zona përreth ndërtesave të banimit, terrenet e lojërave për fëmijë, parqet dhe parqet pyjore, zonat e gjelbërta dhe zonat e larjes, kolatat dhe brigjet e peizazhit.

### Aktivitetet e financuara nga ofrimi i shërbimeve personave juridikë dhe fizikë janë si më poshtë:

1. Shërbimet e pastrimit (mbledhja, transporti dhe deponimi i mbeturinave të shfrytëzuesit të shërbimeve: personat juridikë dhe fizikë),

Duke u nisur nga fakti se kjo shoqëri ishte regjistruar me Vendimin për Themelimin dhe Statutin, e regjistruar, ndër të tjera, për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe zonave të gjelbërta, u bë një ofertë për të ruajtur pastërtinë e hapësirave publike, gjelbërimin dhe më shumë.

Spektori i pastërtimit ka në pronësi dy kamion për mbledhjen e mbeturinave; Volvo dhe BMC Tugra, të cilat janë donacione. Po ashtu posedon makineri të kontraktuara nga Doo "Cistoća" Podgoricë, "Kamion për mbledhjen e mbeturinave Mercedes Axor", "Traktor me rimorkio", "Skip makinë punet MTZ", "Kamion me kiper FAP", "Volkswagen Caddy automjete të pasagjerëve" të cilat mundësojnë më lehtë dhe më mirë ruajtja e pastërtisë në qytetin tonë..

Numri i kontejnerëve të mbeturinave (kontejnerët  $1.1 m^3$ ) - zona e komunës së Tuzit

Kontejnerët $1,1 m^3$	
Tuz dhe Tuz i poshtëm	73
Vuksanlekaj	15
Dreshaj	8
Nënhelm	8
Ploça – Vitoja	5
Hakshabanaj	5
Rakiq	36
Dushiq	5
Lekaj	/
Vlanë	9



Vrane	2
Dheu I Zi	27
Shipshanik	2
Rrogath	9
Haxhaj, Trgaja	9
Milesh	28
Omerbozhaj	18
Dinosha	35
Tojeq	7
Kodërbudan	11
Sukruq	17
Skorraq – Drume	7
Cemi i Trieshit	9
Rranxa e qafs	10
<b>GJITHSEJ</b>	<b>362</b>

Shoqëria zëvendësoi gjithashtu 40 kontejnerë të rinj  $V = 1.1 \text{ m}^3$  si dhe 1  $V = 5 \text{ m}^3$  kontejner të marrë si donacion.

Shporta prej betoni	
Parku në Tuz	10
Shtëpia e Shëndetit	2
QIK Malesia	2
<b>GJITHSEJ</b>	<b>14</b>

Mirëmbajtja e pastërtisë dhe deponimi i mbetjeve në hapësirat publike

Pastrimi i rrugëve (me fshisë) përfshinë grumbullimin e mbeturinave me dorë, pastrimin me një automjet të veçantë, transportimin dhe deponimin e mbetjeve natyrale dhe artificiale (heqjen e mobiljeve të hedhura, mallrave teknike, degëve bimore, rrënojave, etj.), Pastrimin dhe larjen e vendeve publike. Zonat publike përfshijnë: rrugë, rrugica, shtigje për këmbësorë, sheshe, hapësira parkimi.

Elementet për llogaritjen e harxhimeve: Gjatë formimit të çmimeve të shërbimeve për pastrimin e hapësirave publike, si dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta publike, pika e fillimit është tarifa për orë e punëtorëve që përdoret nga libri **NORMATIVI STANDARDI RADA U GRADJEVINARSTVU-NISKOGRADNJA, KNJIGA 6, GN230 (ODRŽAVANJE PUTEVA I KALDRMA U GRADSKIM ULICAMA, IRO GRADJEVINSKA KNJIGA BEOGRAD 1986)**.

**Normativat për pastrimin e rrugëve janë  $9000 \text{ m}^2/8\text{h}$**

**Normativat për pastrimin e hapësirave të gjelbërta janë  $12000 \text{ m}^2/8\text{h}$**

**Normativat për pastrimin e hapësirave publike janë  $25000 \text{ m}^2/8\text{h}$ .**

Hapësira totale për pastrimin me fshisë	9798	$\text{m}^2$
1. Hapësira totale për pastrim	13032	$\text{m}^2$
2. Hapësira totale e gjelbërt		
3. Norma për pastrim me fshisë	$9000 \text{ m}^2$	punëtor/8h
4. Norma për pastrim	$25.000 \text{ m}^2$	Punëtor/8h

5. Norma për pastrim të hapësirës së gjelbërt	12000 m <sup>2</sup>	Punëtor/8h
6. Koha Bruto	2.00	
7. Faktori për rrogë bruto	2.00	
8. Orari I punës	8	h

Në bazë të këtyre elementeve implikon se m<sup>2</sup> pastrim është:

1. Pastrimi i hapësirave publike me fshisë:  $(2.00 \times 2.00 \times 8) / 9000 = 0,0035$  puntori në ditë / m<sup>2</sup>

2. Pastrimi  $(2.00 \times 2.00 \times 8) / 25.000 = 0,0013$  puntori në ditë / m<sup>2</sup>

Pastrimi me fshisë i hapësirave publike

Pastrimi me dorë i hapësirave publike në teritorin e Komunës së Tuzit

Reonet	NJ.M.	Sipërfaqja	Çmimi në Njësi	Sasia në €
1.Vuksanlekaj Ul. 1	m <sup>2</sup>	750	0,0035	2.62
2.Tuz Rr. 3	m <sup>2</sup>	3645	0,0035	12.75
3.Tuz Rr. 2	m <sup>2</sup>	2340	0,0035	8.19
4.Tuz Rr. 1	m <sup>2</sup>	1902	0,0035	6.65
5.Tuz Rr. 12	m <sup>2</sup>	1161	0,0035	4.06

Java e punës në shërbimin e Pastrimit është 6 ditë, dmth nga e Hëna në të Shtune.

#### ZONA 1

Rruga	Çmimi/ditë	Ditët e punës	Sasia në Euro
1.Vuksanlekaj Rr. 1	2.62	325	851.5
2.Tuz Rr. 3	12.75	325	4143.75
3.Tuz Rr. 2	8.19	325	2661.75
4.Tuz Rr. 1	6.65	325	2161.25
5.Tuz Rr. 12	4.06	325	1319.5
<b>GJITHSEJ:</b>			<b>11.137,75</b>

#### Pastrimi i hapësirave publike më frekvente

Përfshinë punët e pastrimit të rrugëve në teritorin e Komunës së Tuzit.

